



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:113245

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05423869

Ac.nr.2409/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS sh.a, Distrikti në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.P., nga Prizreni, kundër të paditurit A.Xh., nga fshati P....., Komuna e Prizrenit, me objekt kontesti kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës të paditurit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.499/2018 të datës 13.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurit A.Xh., nga fshati P....., Komuna e Prizrenit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.499/2018 i datës 13.01.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.499/2018 të datës 13.01.2021, në pikën një të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS sh.a, Distrikti në Prizren. Në pikën dy, ka detyruar të paditurin A.Xh., nga fshati P....., Komuna e Prizrenit, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar për shkak të lidhjes së pa autorizuar në shërbime, t'ia paguaj paditëses shumën prej 3,309.30 euro, duke filluar nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pikën tre, ka detyruar të paditurin A.Xh., nga fshati P....., Komuna e Prizrenit, që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS sh.a, Distrikti në Prizren, shumën prej 60.00 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i padituri, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, aktgjykimin ankimor të prish dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, të precizuar në seancën e datës 13.01.2021, ka kërkuar që të detyrohet i padituri për kompensimin e dëmit material, në shumë prej 3,309.30 euro.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për aprovimin e të kërkesëpadisë, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave: aktgjykimi penal P.nr.1979/16 datë 14.12.2017, fatura numër XXXXX datë 31.10.2015, fatura DPZ XX HPXXXX datë 24.05.2016, ekspertiza e ekspertit të elektroteknikës M.G., datë 06.03.2020. Gjykata e shkallës së parë, pas vërtetimit të bazës së kërkesëpadisë e cila është kontestuar nga i padituri, ka vendosur lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit material duke u bazuar në dispozitën e neni 136, 140 dhe 245 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 452.1 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, se dispozitivi është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin. Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Aktgjykimi përmban edhe referencën sa i përket të

drejtës materiale me shpjegime se si është zbatuar e drejta materiale në raport me gjendjen faktike të cilën e ka provuar gjykata e shkallës së parë në këtë çështje kontestuese.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë konkludimin e saj e ka bazuar në aktgjykimin penal, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë dhe caktimit të lartësisë së dëmit, pasi që në rastin konkret rezulton se gjykata e shkallës së parë plotësisht i ka vërtetuar faktet të cilat kanë qenë me rëndësi vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore dhe për këto fakte në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqit arsye të plota, sepse nga të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të cilat janë elaboruar në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, rezulton se i padituri është e detyruar që paditëses t'ia kompensoj dëmin sipas aktgjykimit penal.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, për shkak se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, ku me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, aktgjykimin e ka bazuar në dispozita konkrete ligjore që i referohen çështjes e cila është objekt i këtij kontesti në rastin konkret. Me dispozitën 136, paragrafi 1 të LMD-së, është përcaktuar se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Me vet faktin se i padituri me asnjë provë bindëse e të argumentuar, nuk ka arritur që të provoj pafajësinë e tij, atëherë edhe gjykata e shkallës së dytë të njëjtin e konsideroi si përgjegjës për shkaktimin e dëmit paditëses dhe e obligoi që këtë dëm të njëjtit t'ia kompensoj.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2409/2021, me datë 05.03.2024

Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.